



Fletë udhëzuese për kriteret e integrimit¹

Më dt. 1 janar 2019 ka hyrë në fuqi Ligji i revizionuar federal për të huajat dhe të huajt dhe për integrimin (Ligji për të huajt dhe për integrimin, AIG). Ndryshimet përkatëse lidhur me këtë, në njërën anë synojnë të nxitin integrimin e të huajave dhe të huajve nëpërmjet heqjes së pengesave të integrimit dhe, në anën tjetër të kërkojnë në mënyrë më të detyrueshme përgjegjësinë vetjake për integrimin. Për këtë vlen parimi: Sa më shumë të drejta të marrin persona me shtetësi të huaj, aq më i mirë duhet të jetë integrimi. Kjo do të thotë, që në veçanti njohuritë e gjuhës janë të lidhura ngushtë me statutin e qëndrimit. Për vlerësimin e integrimit të çdo personi individualisht shërbejnë kriteret e mëposhtme të integrimit:

Kriteret e integrimit (neni 58a AIG)

► **Kompetenca gjuhësore**

Për dhënien dhe zgjatjen e një leje kërkohen, sipas statutit të qëndrimit, kompetenca të ndryshme gjuhësore.

► **Respektimi i sigurisë dhe rendit publik**

- Nuk duhet të bëhen shkelje të rëndësishme ose të përsëritura kundër dispozitave të autoriteteve.
- Respektimi i detyrimeve ligjore publike dhe private (p.sh. pa detyrime përmbarimi, pa borxhe tatimore, pa falimentime etj.)

► **Respektimi i vlerave të kushtetutës federale**

Orientim në parimet e shtetit juridik si dhe të rendit bazë liberal demokratik të Zvicrës. Si të drejta themelore dhe detyrime theksohen në veçanti:

- barazia e të drejtave të burrit dhe gruas
- e drejta për jetë dhe liri personale
- liria e besimit dhe ndërgjegjes si dhe liria e mendimit të lirë
- detyrimi për ndjekjen e shkollës së detyrueshme

► **Pjesëmarrje në jetën ekonomike apo në përfitimin arsimor**

- Mbulimi i kostove të jetesës me anë të të ardhurave, pronës apo shërbimeve të të tretëve, mbi të cilat ekziston një pretendim (p.sh. pagesa të AHV [Sigurimi i pleqërisë dhe pasardhësve] dhe IV [Sigurimi i invaliditetit], kompensimi i papunësisë)
- Mosmarrja e ndihmave sociale
- Pjesëmarrje në formime profesionale apo kualifikime të mëtejshme

Pasoja në rast të integrimit të mjaftueshëm:

Nëse nuk përmbushen kriteret e integrimit, atëherë nuk mund të zgjatet leja e qëndrimit ose mund të prapësohet leja e përhershme e qëndrimit dhe të zëvendësohet me lejen e qëndrimit (rikthim një shkallë mbas). Gjithashtu mund t'ju hidhet poshtë kërkesa për bashkim familjar apo t'ju refuzohet kërkesa për nënshtetësi.

Bashkimi familjar: Kujdes afatet!

¹ Gjendja 1 qershor 2019

Për titujt e ndryshëm të qëndrimit kërkohen dëshmitë e mëposhtme gjuhësore

Titulli i qëndrimit	Dhënia	Kompetencat e nevojshme gjuhësore
Marrja e nënshtetësisë	Marrja e lehtësuar e nënshtetësisë të bashkëshortëve zviceranë pas 5 vitesh	Me gojë B1, me shkrim A2
	Marrja e rregullt e nënshtetësisë pas 10 vitesh	Me gojë B1, me shkrim A2
Leja e përhershme e qëndrimit	Dhënie e rregullt pas 10 vitesh qëndrimi	Me gojë A2, me shkrim A1
	Dhënie e parakohshme e lejes së përhershme të qëndrimit në rast të integritimit të mirë pas 5 vitesh qëndrimi	Me gojë B1, me shkrim A1
	Bashkëshortët e nënshtetaseve zvicerane dhe nënshtetasve zviceranë pas 5-vitesh jetë martesore	Me gojë A2, me shkrim A1
	Bashkëshortë të personave me qëndrim të përhershëm pas 5 vitesh jetë martesore	Me gojë A2, me shkrim A1
	Dhënie pas 5 vitesh qëndrimi për persona nga Belgjika, Danimarka, Gjermania, Franca, Greqia, Italia, Lihtenshtaini, Holanda, Austria, Portugalia, Spanja	Asnjë
Leja e qëndrimit me anë të bashkimit familjar	Bashkëshortëve nëpërmjet personave nga shtetet e treta me lejë qëndrimi C, B ose F	Me gojë A1, me shkrim asnjë kërkesë
	Bashkëshortëve nëpërmjet personave nga shtetet e BE-së / EFTA [Asociacionit Evropian të Tregut të Lirë]	Asnjë
	Bashkëshortëve nëpërmjet nënshtetaseve zvicerane dhe nënshtetasve zviceranë	Asnjë

Informacione të mëtejshme:

- ▶ Për pyetje rreth lejes së qëndrimit, zgjatjes/shndërrimit të lejes, bashkimit familjar, afateve: Enti i migracionit & zyra e pasaportave, Mühlentalstrasse 105, 8200 Schaffhausen, Tel. 052 632 74 76, migrationsamt@ktsh.ch
- ▶ Për konsultim dhe pyetje rreth integritimit dhe mësimin të gjuhës: Vendi i specializuar për integrimin Integres, Krebsbachstrasse 61, 8200 Schaffhausen, Tel. 052 624 88 67, info@integres.ch, www.integres.ch
- ▶ Certifikatat e njohura gjuhësore: <https://www.fide-info.ch/>> Lista e certifikatave të njohura gjuhësore